

V E N D I M
Nr.678, datë 14.10.1996

PËR PËRDORIMIN E LETRAVE ME VLERË PËR MBULIMIN E DEFICITIT BUXHETOR

Për një mobilizim më të efektshëm të burimeve të brendshme monetare përkohësisht të lira për mbulimin e deficitit buxhetor, si dhe për të ndihmuar në zhvillimin e tregut të letrave me vlerë, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Financave, nëpërmjet strukturave të saj të brendshme, të emetojë bono thesari afatshkurtër për mbulimin e deficitit buxhetor të parashikuar në ligjin e buxhetit të çdo viti, ose të deficitit të përkohshëm të arkës që mund të krijohet në periudha të caktuara brenda vitit buxhetor.

2. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të nxjerrin udhëzimin përkatës për procedurat teknike të emetimit, blerjes, regjistrimit kontabël të bonove të thesarit, si dhe detyrimet përkatëse të palëve.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.103, datë 15.3.1994 “Për autorizimin e Ministrisë së Financave të përdorë bonot e thesarit për mbulimin e pjesshëm të deficitit buxhetor”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi